

# TË KUPTUARIT E NDËRKULTURALITETIT

 udhëzues i shkurtër

TITULLI I PUBLIKIMIT:  
**TË KUPTUARIT E NDËRKULTURALITETIT**



Botues:

**OJQ Horizonti i Ri**

rr. Kodra pn, Ulqin

Tel: +382 68 300 603

E-mail: horizon@t-com.me

www.ngo-horizonti.org

 newhorizonngo

Për botuesin:

**Nazif Veliq**

Autorë dhe bashkëpuntorë:

**Radomir Petriq**

**Hazreta Cuca**

**Mustafa Canka**

**Hakile Resulbegoviq**

Faqosja dhe dizajni:

**Alma Sulejmanoviq**

Shtypi:

**Promotive - Podgorica**

**Ulqin, gusht 2022.**

*Publikimi i këtij udhëzuesi është pjesë e projektit „**KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR I TË RINJVE: SFIDAT DHE MUNDËSITË**“ të cilin OJQ Horizonti i Ri e realizoi me mbështetjen financiare të Ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave të Malit të Zi. Përmbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi vetëm e autorit dhe nuk pasqyron detyrimisht qëndrimet dhe pikëpamjet e donatorit.*

## HYRJE SHKURTËR

Edukimi ndërkulturor sot është shumë i rëndësishëm dhe paraqet një platformë ideale për promovimin e barazisë dhe të drejtave të njeriut; kundërshton padrejtësinë dhe diskriminimin; është një alternativë që promovon dhe favorizon dinamikën e gjithëpërfshirjes në të gjitha proceset brenda mjedisit arsimor. Kjo ngre pyetjen nëse arsimi formal arrin t'i përgjigjet mjaftueshëm rrethanave shoqërore dhe se si të rinjtë do t'i kuptonin këto tema nëse do t'i vëzhgonin ato përmes mënyrës klasike dhe formale të të mësuarit.

Mungesa e informacionit dhe keqinformimi janë nga problemet më të rëndësishme të komunitetit. Narrativi aktual dhe retorika përçarëse që reflektojnë në skenën e ndarë publike në Mal të Zi, kontribuojnë në bashkëpunimin e dobët ndërmjet kategorive të ndryshme shoqërore apo edhe në dialogun negativ ndëretnik, ndërfetar dhe ndërkulturor.

Kjo broshurë dygjuhëshe fokusohet veçanërisht në rëndësinë e forcimit të dialogut ndërkulturor në sistemin arsimor, sepse pikërisht në këtë proces, ndërveprimi mes të rinjve me përkatësi të ndryshme është në nivel shumë të ulët.

Udhëzuesi është një literaturë e lehtë që ndërthur teorinë dhe praktikën, duke i siguruar lexuesit informacionin bazë, përkufizimet e termave dhe shembuj të përvojës së mirë ndërkulturore. Materiali i mbledhur dhe i përpunuar në këtë udhëzues paraqet konceptet kyçe që lidhen me edukimin ndërkulturor, modelet e tejkalimit të barrierave kulturore në shoqërinë moderne dhe përshkruan parimet e kompetencave ndërkulturore.

Krahas të rinjve, ky publikim iu dedikohet edhe mësimeve, të cilët mund të gjejnë modele se si të punojnë me të rinjtë në temën e ndërkulturalitetit, në mënyrë që së bashku të arrijnë të kuptojnë tema të rëndësishme dhe gjërat kyçe të këtij koncepti, të nevojshme për zhvillimin e një të riu.

Njëkohësisht, udhëzuesi është hartuar me shembuj të edukimit ndërkulturor në vende të ndryshme që kontribuojnë në zhvillimin individual dhe përgatitjen e nxënësve për jetë dhe punë të përgjegjshme në një mjedis shumëkulturore siç është ky i yni.

Me shpresën se ky udhëzues do të jetë i dobishëm në kërkimin e mirëkuptimit midis kulturave të dhe grupeve të ndryshme shoqërore, autorët i urojnë të gjithë lexuesve një udhëtim të bukur dhe të sigurt drejt botës së ndërkulturalitetit.

# FJALORTH KONCEPTESH

## Çfarë është ndërkulturaliteti?

*Temës së ndërkulturalitetit le t'ia nisim me radhë, pra nga vetë përkufizimi i këtij termi. Përkufizimi përgjithësisht i pranuar është se termi ndërkulturalitet nënkupton një marrëdhënie, një shkëmbim dhe një sërë rrjedhash dinamike të kulturave të ndryshme, në dallim nga termi tjetër, gjithashtu shumë i përhapur sot, multikulturaliteti, që nënkupton ekzistencën e disa kulturave në të njëjtën hapësirë. Pra, ndërkulturaliteti nënvizon marrëdhënien ndërmjet kulturave dhe domosdoshmërinë e ndërveprimit të ndërsjellë.*

*Ndërkulturaliteti nënkupton ballafaqimin me problemet që lindin nga marrëdhëniet midis bartësve të kulturave të ndryshme, si dhe pranimin e respektimit i tyre. Këtu, parashtesa ndër- nuk do të thotë përzjerje e kulturave dhe nuk është as zëvendësim i një forme mendimi me një tjetër: është mundësia e krahasimit të mendimeve, të ideve dhe të kulturave të ndryshme në një hapësirë.*

## Kultura

Me qëllim që të kuptojmë më mirë vetë kontekstin e temës së ndërkulturalitetit, është shumë e rëndësishme që fillimisht t'i njohim ndryshimet e domethënieve të termave më të përdorur në këtë lëmi. Koncepti kultura është parësori dhe ai mund të përkufizohet në disa mënyra. Njëra prej tyre e përcakton kulturën si një bashkësi shenjash përmes të cilave pjesëtarët e shoqërisë e identifikojnë njëri-tjetrin dhe i bën ata të dallojnë nga njerëzit që nuk i përkasin asaj shoqërie. Përkufizimi tjetër thekson se kultura është një grup modelesh identifikuese intelektuale, materiale, shpirtërore dhe emocionale të një shoqërie ose të një grupi social të caktuar, i cili përfshin stilin e tyre të jetesës dhe mënyrat e tyre të bashkëjetuarit, sistemet e tyre të vlerave, artin, traditat, besimet, letërsinë.

Bazuar në këto dhe shumë definicione të tjera, mund ta formulojmë edhe përkufizimin sipas të cilit kultura është "programim" kolektiv i mendjes, i llojit të vet, i cili i dallon pjesëtarët e një grupi shoqëror nga pjesëtarët e grupeve të tjera, në të cilin modelet e të menduarit, të ndjenjave dhe të potencialit për të reaguar janë kryesisht të fituara në fëmijëri, në moshën më të ndjeshme ndaj të mësuarit dhe asimilimit. Në fund të fundit, kjo tregon për rolin e jashtëzakonshëm të arsimit institucional në formimin e vetëdijes për rëndësinë e ndërkulturalitetit në popullatën shkollore.

Në këtë mënyrë, çdo të menduar për kulturën na çon gjithmonë drejt vështrimit të marrëdhënieve midis kulturave, gjegjësisht ndërveprimit midis tyre, ashtu që dallimet kulturore që shohim midis njerëzve çojnë tek të perceptuarit e ekzistencës së vetë kulturës, gjegjësisht të kulturave të ndryshme.

## Multikulturalizmi dhe ndër-kulturalizmi - dallimet

Termi *multikulturor* nënkupton diversitetin kulturor të shoqërisë njerëzore dhe nuk i referohet vetëm elementeve të kulturës etnike ose kombëtare, por përfshin edhe dallimet në fushën e besimit/fesë, gjuhës, si dhe në fushën e dallimeve socio-ekonomike. Këtu është e rëndësishme të kihet parasysh statika e veçantë sociale që karakterizon multikulturalizmin, e që është fakti se njerëzit e kulturave të ndryshme jetojnë pranë njëri-tjetrit.

Kështu, multikulturalizmi mund të përshkruhet gjithashtu si një areal shpirtëror, në të cilin kulturat e ndryshme ekzistojnë përkrah duke mos i ndryshuar karakteristikat e njëra-tjetrës. Ai, gjithashtu, duke i vënë në pah dallimet kulturore e jo ngjashmëritë dhe pranimin e tyre reciprok, mund të çojë edhe në ndarjen ose izolimin e kulturave të ndryshme, pra, mund të çojë në një lloj geto-kulturalizmi.

Në anën tjetër, termi *ndër-kulturor* ka një dinamikë sociale, sepse lidhet me vendosjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet grupeve të njerëzve që u përkasin kulturave të ndryshme. Me pak fjalë, ndër-kulturalitet do të thotë kur kulturat e ndryshme jetojnë në bashkëveprim, i cili nënkupton interesim të ndërsjellë, si dhe pranim dhe respekt reciprok.

Duke theksuar raportin ndërmjet kulturave dhe domosdoshmërinë e ndërveprimit të tyre, ndër-kulturaliteti nënkupton edhe ballafaqimin me problemet që dalin nga marrëdhëniet midis bartësve të kulturave të ndryshme. Ai nxit të menduarit për dallimet e natyrës etnike, kulturore, fetare e të tjera, për luftën kundër paragjytimeve, për jetën paqësore të popujve dhe individëve ose grupeve me origjinë të ndryshme. Gjithashtu, interkulturaliteti të udhëzon për të menduar rreth mundësive të barabarta në arsim ose në shprehjen e mendimeve, qëndrimeve, orientimeve seksuale të ndryshme, në kundërshtim me normën shoqërore mbizotëruese. Ndër-kulturaliteti nënkupton edhe mundësinë e ballafaqimit të ideve, gjë që nxjerr në pah edhe nevojën për ndryshime në mënyrën e të menduarit.

Pra, ndër-kulturaliteti presupozon multikulturalitet dhe në çdo segment të vetin është ndërveprues, i përcaktuar që kulturat të japin e marrin me njëra-tjetrën, si dhe të dialogojnë në të gjitha nivelet, nga ai lokal në atë ndërkombëtar.

Për të ndarë kuptimin e koncepteve ndër-kulturor dhe multikulturor, duhet mbajtur gjithmonë parasysh se të dy përdoren për të treguar faktin se në një komunitet apo në një shtet ka më shumë se një kulturë. Në diskursin publik, termi multikulturor zakonisht përdoret për të përshkruar një shoqëri në të cilën dallimet, gjegjësisht kulturat e ndryshme, jetojnë krah për krah me njëra-tjetrën dhe njëkohësisht nuk shprehin ndërveprim të veçantë, ndërsa termi ndër-kulturalizëm bazohet në bindjen se çdo burrë dhe grua, çdo individ shoqëror, bëhet më i pasur pikërisht përmes kontakteve, përshkimeve me kulturat e tjera dhe nëpërmjet përvojave të arritura në këtë mënyrë.

# MODELET E EDUKIMIT NDËRKULTUROR

## Ndërkulturaliteti - rruga drejt një shoqërie më demokratike

Në çdo shoqëri demokratike, një ndër qëllimet kryesore të arsimit është avancimi i demokracisë në komunitet. Në mënyrë që ky qëllim të arrihet plotësisht, sistemi arsimor në një shoqëri demokratike ka për detyrë që ta analizojë dhe ta kuptojë plotësisht karakterin multikulturor të vetë shoqërisë dhe për zbatimin e këtij qëllimi duhet të synojë një kontribut aktiv, si për bashkëjetesë paqësore, ashtu edhe për ndërveprim pozitiv të grupeve të ndryshme shoqërore dhe kulturore.

Sipas njërit prej përkufizimeve më të njohura, ndërkulturalizmi është pikëpamja ku njerëzit e kulturave të ndryshme mund dhe duhet të jenë në gjendje të lidhen dhe të mësojnë nga njëri-tjetri.

## Konceptet kryesore të edukimit

Ekzistojnë dy koncepte bazë të qasjes tradicionale ndaj kësaj sfere të arsimit, e që janë: edukimi multikulturor dhe ndërkulturor.



*Edukimi multikulturor përqipet që, përmes të mësuarit për kulturat e tjera, të mundësojë pranimin ose të paktën tolerancën ndaj kulturave të tjera, që do të thotë se, në thelb, këtu kemi pranimin e një modeli të bashkëjetesës pasive, pa ndërveprim të shprehur, gjegjësisht pa ndërveprim të dukshëm.*



*Në anën tjetër, konceptualisht, edukimi ndërkulturor dëshiron ta kapërcejë këtë gjendje status quo-je, ta kapërcejë boshllëkun midis palëve që ruajnë një ekuilibër pasiv social dhe në mënyrë proaktive të veprojnë drejt arritjes së një modeli të zhvilluar dhe të qëndrueshëm të jetës së përbashkët në një shoqëri multikulturore.*

Me qëllim të arritjes së këtyre synimeve, koncepti i edukimit ndërkulturor synon të kontribuojë në ndërtimin e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë, si dhe në dialogun ndërmjet grupeve të kulturave të ndryshme. Një çështje tejet e rëndësishme është edhe sigurimi i mundësive të barabarta, si dhe lufta kundër diskriminimit.

## Synimet e edukimit ndërkulturor

Edukimi ndërkulturor promovon dhe zhvillon të kuptuarit më mirë të kulturave në shoqërinë moderne, nxit aftësinë e komunikimit ndërmjet pjesëtarëve të kulturave të ndryshme dhe zhvillon një pikëpamje më elastike ndaj diversitetit kulturor në shoqëri.

Ndër synimet e edukimit ndërkulturor është edhe vendosmëria që pjesëtarët e një komuniteti të arrijnë të jenë më të gatshëm, që në mënyrë aktive, të përfshihen në ndërveprim social me njerëzit e një origjine tjetër kulturore dhe kështu, për t'u kapërcyer barrierat kulturore, me këtë edhe ato sociale në komunitet dhe shtet, si dhe karakteristikat e cilësitë thelbësore të natyrës njerëzore të njihen për të gjithë si diçka e përbashkët për të tërë.

## Edukimi ndërkulturor si proces

Në temën rreth edukimit ndërkulturor, po ashtu është shumë e rëndësishme të kuptohet se edhe ky është një proces, i cili kërkon nga çdo pjesëtar i komunitetit/shoqërisë që së pari të njohë veten dhe kulturën e tij, në mënyrë që të mund t'i kuptojë kulturat e pjesëtarëve të tjerë të komunitetit / shoqërisë / shteteve.

Prandaj, ky proces është shumë kërkuar, pasi përfshin punën për të kapërcyer bindjet, qëndrimet dhe paragjykimet e ngurtësuar në lidhje me të mirën dhe të keqen. Në këtë proces nuk është aspak më pak sfidues rishqyrtimi i pikëpamjeve personale për botën dhe për jetën. E parë në këndvështrimin postmodernist, gjithçka e rrënjosur, në mësimin ndërkulturor vihet nën shqyrtim, përsiatet në mënyrë kritike, vrojtohet dhe rishqyrtohet.

Ndaj, të mësuarit ndërkulturor është një sfidë për shoqërinë, si për identitetin personal ashtu edhe për atë në grup të pjesëtarëve të shoqërisë, megjithatë, gjatë këtij procesi është e mundur që ky të bëhet edhe një "mjet" social, një mënyrë se si t'i pasurojmë këto identitete. Duke qenë se edukimi ndërkulturor është një proces ku mësojmë se si të jetojmë së bashku në botën e diversitetit, ai me këtë përbën fillimin e udhës në ndërtimin e jetës paqësore të përbashkët.

# UNESCO: PARIMET E EDUKIMIT NDËRKULTUROR

## Respektimi i identitetit kulturor

Edukimi ndërkulturor respekton identitetin kulturor duke ofruar edukim të përshtatshëm kulturor, të hapur dhe cilësor për të gjithë. Kjo arrihet përmes:

- ◆ promovimit të mjedisit mësimor që respekton dallimet kulturore;
- ◆ zhvillimit dhe aplikimit të metodave të suksesshme të edukimit që u korrespondojnë kulturave të cilave u referohen;
- ◆ zhvillimit dhe aplikimit të metodave të vlerësimit në përputhje me veçantitë e kulturave të ndryshme;
- ◆ përzgjedhjes së gjuhës amtare të nxënësit si gjuhë mësimi kudo që të jetë e mundur;
- ◆ trajnimit të duhur të mësimitdhënësve me qëllim edukimin e tyre për traditat kulturore të vendit të tyre;
- ◆ familjarizimit të mësimitdhënësve me metodat e provuara të mësimitdhënies kontekstuale;
- ◆ përdorimit të materialeve dhe kurrikulës për mësimitdhënie;
- ◆ sensibilizimit për nevojat arsimore dhe kulturore të grupeve pakicë;
- ◆ mbështetjes së mësimitdhënësve për të përshtatur përmbajtjen mësimore, metodën e punës dhe materialin që përdorin për nevojat e grupeve, kulturat e të cilave janë të ndryshme nga shumica;
- ◆ të shfrytëzuarit e diversitetit si mjet mësimi;
- ◆ ndërveprimin midis shkollës dhe komunitetit dhe përfshirjes së prindërve dhe bashkësive lokale në procesin mësimor.

## Ofrimi i njohurive kulturore

Edukimi ndërkulturor u jep të gjithë nxënësve njohuri, aftësi dhe qëndrime kulturore të nevojshme për të qenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në shoqëri. Kjo mund të arrihet përmes:



- ◆ sigurimit të kushteve të barabarta dhe të drejta në arsim, siç janë: qasja e barabartë në arsim cilësor dhe mënjanimi i diskriminimit;
- ◆ përdorimit të kurrikulës, teksteve shkollore dhe materialeve të punës, që kulturës/komunitetit shumicë u ofrojnë njohuri rreth kulturave të pakicave;
- ◆ krijimit të mundësive që grupet pakicë të mësojnë për shoqërinë/komunitetin në tërësi;
- ◆ përfshirjes së sistemeve të ndryshme kulturore përmes shfaqjes së dijeve nga këndvështrime të ndryshme kulturore;
- ◆ përdorimit të metodave të përshtatshme të mësimdhënies - të mësuarit aktiv, pjesëmarrës, dhe bashkëpunues (kooperativ);
- ◆ përkufizimit të qartë dhe vlerësimit të saktë të arritjeve të nxënësve – të njohurive, të aftësive, të qëndrimeve të tyre dhe të vlerave;
- ◆ përdorimit të gjuhës së përshtatshme mësimore, e cila çdo nxënës i jep mundësinë që të komunikojë, gjegjësisht të shprehet në gjuhën e tij amtare dhe në gjuhën zyrtare të vendit ku jeton, si dhe në një ose më shumë gjuhë të huaja;
- ◆ arsimimit adekuat të mësimdhënësve dhe aftësimit të tyre profesional.

## Respekti, mirëkuptimi dhe solidariteti

Edukimi ndërkulturor u siguron të gjithë nxënësve njohuri, aftësi dhe qëndrime kulturore që u mundësojnë atyre të kontribuojnë në respektin, mirëkuptimin dhe solidaritetin ndërmjet individëve, grupeve etnike, sociale e kulturore dhe kombeve. Kjo mund të arrihet përmes:









- ◆ zhvillimit të një kurrikule që kontribuon në kuptimin dhe vlerësimin e diversitetit kulturor, por edhe të varësisë globale midis njerëzve, zhvillimin e ndërgjegjësimit për të drejtat dhe detyrimet, kuptimin e domosdoshmërisë së solidaritetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;
- ◆ aplikimit të metodave të përshtatshme të mësimdhënies dhe të të nxënës;
- ◆ zhvillimit të aftësive të komunikimit dhe të bashkëpunimit përtej kufijve kulturore;
- ◆ mësimdhënies dhe mësimi të gjuhëve të huaja dhe avancimit të komponentëve kulturorë të mësimi të gjuhëve;
- ◆ arsimimit të duhur të mësimdhënësve dhe aftësimit profesional të pandërprerë.

# GABIMET NË TË KUPTUARIT E EDUKIMIT NDËRKULTUROR

## Gabime tipike tashmë të definuara

Në praktikën e deritanishme të shkollave ku zbatohet edukimi ndërkulturor, pedagogët, sociologët dhe kulturologët kanë vënë re, kanë përshkruar dhe definuar 15-të gabime tipike në kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e tij.

- ◆ Është bindje e gabuar se njerëzit e të njëjtës kombësi, të njëjtit rajon gjeografik ose njerëzit që flasin të njëjtën gjuhë, i përkasin të njëjtës kulturë. Shumë shembuj, që nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e deri tek vendet sllavojugore, tregojnë se origjina e përbashkët kombëtare, gjuhësore ose gjeografike nuk nënkupton se të gjithë anëtarët e asaj *shoqërie/atij* shteti i përkasin të njëjtit grup etnik dhe kulturor.
- ◆ Është bindje e gabuar që familjet nga e njëjta kulturë kanë të njëjtat vlera. Kjo vlen në veçanti për anëtarët e grupeve jodominuese në një kulturë të caktuar ose për të ashtuquajturit të ardhurit, të cilët mund ta pranojnë plotësisht një kulturë të re dhe kështu të kenë një identitet të dyfishtë kulturor, pra t'i krijojnë vetes identitete të reja kulturore. Praktika tregon se në një familje, zakonisht brezi më i vjetër, e ruan modelin dhe identitetin e vjetër kulturor, ndërsa brezi tjetër, kryesisht brezi më i ri, mund të ketë dy identitete kulturore.
- ◆ Është bindje e gabuar se librat për fëmijë që flasin për kulturat e tjera janë përgjithësisht autentike. Domethënë, edhe pse argëtuese, cilësore dhe të përshatura për moshën, shumë libra për fëmijë përmbajnë stereotipe etnike dhe paragjykime për kulturat për të cilat flasin.
- ◆ Është bindje e gabuar se edukimi ndërkulturor trajton vetëm tema dhe çështje racore dhe etnike. Ndonëse ato përbëjnë pjesën më të madhe të përmbajtjes së tij, edukimi ndërkulturor domosdoshmërisht përfshin çështjet e barazisë gjinore dhe socio-ekonomike, si dhe hulumton dallimet kulturore që ekzistojnë midis grupeve të ndryshme sipas gjinisë dhe statusit socio-ekonomik.
- ◆ Është bindje e gabuar se udhëtimet ose vizitat që i bëhen kulturave të tjera janë një qasje adekuatë për edukimin ndërkulturor. Kjo qasje zakonisht nënkupton përfshirjen e përkohshme në kurrikulë e jo sistematike të temave rreth kulturave të ndryshme; ndërsa për kulturat e tjera diskutohet vetëm me rastin e datave dhe ngjarjeve të caktuara. Përveç kësaj, është e rrezikshme nëse udhëtimet ose vizitat e tilla i përforcojnë stereotipet dhe paragjykimet për kulturat e tjera.
- ◆ Është bindje e gabuar se edukimi ndërkulturor duhet të jetë lëndë më vete. Domethënë, në këtë mënyrë vetëm shtohet një lëndë e re, e cila nuk ndryshon dukshëm kurrikulën tashmë ekzistuese apo mënyrën e të menduarit të nxënësve për kulturën e vet dhe për kulturat e tjera. Po ashtu, është e rrezikshme kur mësimdhënësit ose nxënësit e përjetojnë këtë vetëm si një ngarkesë shtesë në punë.
- ◆ Është bindje e gabuar se edukimi ndërkulturor është përgjithësisht i pranueshëm. Jemi dëshmitarë se në shumë vende ka lloje të ndryshme rezistence nga ekspertë dhe media me qëllim të përjashtimit të ndërkulturës nga shkollat.

- 
 Është bindje e gabuar se edukimi ndërkulturor ndan, në vend që të bashkojë. Qëndrimet e tilla burojnë nga mohimi i shtresëzimit të një shoqërie dhe nga frika e përballjes me këtë situatë, gjegjësisht të studimit të shkaqeve të paraqitjes së saj dhe zbulimit të mënyrave më të mira të të jetuarit së bashku, që është edhe një nga qëllimet e edukimit ndërkulturor.
- 
 Është bindje e gabuar që shoqëritë njëkombëshe ose komunitetet që kanë një ose dy kultura, nuk kanë nevojë për edukim ndërkulturor, apo për të mësuar rreth kulturave të tjera. Mënyra moderne e jetesës thellësisht i redukton distancat midis kulturave të ndryshme dhe rrit pikëpamjet dhe shpeshhtësinë e takimeve të tyre. Duke i njohur kulturat e tjera, nxënësit janë në gjendje ta kuptojnë më mirë kulturën e tyre dhe të fitojnë aftësi, të cilat do t'u mundësojnë që të orientohen në mjedisin e tyre pranë kulturave dhe komuniteteve të tjera.
- 
 Është bindje e gabuar që edukimi ndërkulturor është i aplikueshëm vetëm për nxënësit më të rritur që e kanë pjekurinë e duhur për t'i kapërcyer fazat e egocentrizmit dhe etnocentrizmit. Ashtu si edhe me mësimin e gjuhëve të huaja, rezulton se në praktikë fëmijët i mësojnë modelet e reja kulturore shumë më lehtë sesa të rriturit, me kusht që përmbajtja dhe qasja e edukimit ndërkulturor t'i përshtaten moshës së tyre.
- 
 Është bindje e gabuar se futja e edukimit ndërkulturor çon në zbehjen e ndjenjës për komunitetin ose përkatësinë e një grupi më të madh. Një qëndrim i tillë buron nga mohimi i shtresëzimit të një shoqërie dhe nga frika se përballja me dallimet mund të çojë në konflikte dhe trazira të brendshme. Edukimi ndërkulturor të çon drejt një përballjeje konstruktive me dallimet, drejt kuptimit të burimeve dhe shkaqeve të tyre dhe drejt zbulimit të mënyrave më të mira dhe më të drejta të të jetuarit së bashku.
- 
 Është bindje e gabuar se shoqërive shumëetnike, të cilat i pranojnë dallimet kulturore, nuk u nevojitet edukimi ndërkulturor. Duke i njohur kulturat e tjera, nxënësit janë në gjendje ta kuptojnë më mirë kulturën e tyre dhe të ndërtojnë një shoqëri më të drejtë dhe më tolerante kundrejt dallimeve.
- 
 Është bindje e gabuar se edukimi ndërkulturor relativizon të vërtetën historike. Në momentin kur nxënësit ta zhvillojnë aftësinë për të vënë në dyshim tema dhe të vërteta të paprekshme, atëherë do të jenë në gjendje të hulumtojnë dallimet në këndvështrimet e ndryshme për historinë sipas literaturave të ndryshme.
- 
 Është bindje e gabuar që njerëzit kryesisht të identifikohen me një kulturë. Sot në botë, sipas statistikave të disponueshme, numri i fëmijëve dhe familjeve me natyrë multi-etnike - multikulturore është në rritje të vazhdueshme. Janë të shumta edhe martesat e përziera dhe familjet që përkohësisht ose përgjithmonë kanë ndryshuar vendbanimin e tyre duke u shpërngulur nga një kulturë/rajon, shtet apo kontinent në një tjetër. Edukimi ndërkulturor trajton po ashtu edhe identitetet kulturore ndërpersonale, duke u mundësuar nxënësve që të përballen në mënyrë konstruktive me konfliktet e brendshme
- 
 Është bindje e gabuar se nuk ka mjaft resurse/materiale, burime të nevojshme për edukimin ndërkulturor. Të moshuarit thonë: "kush kërkon, gjen", që praktikisht do të thotë se ky plan mund të nisë përmes metodës kërkimore më të zakonshme – kërkimit në faqet e internetit, por edhe përmes studimit të burimeve të komunitetit lokal. Gjëja më e rëndësishme është që vetë nxënësit të pranohen si burimet më të rëndësishme të ndërkulturalitetit, për këtë, mësimdhënësit duhet t'i krijojnë kushtet në të cilat nxënësit do të mësojnë nga njëri-tjetri përmes shkëmbimit të koncepteve, përvojave dhe këndvështrimeve të ndryshme.

# KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR

## Rëndësia e komunikimit ndërkulturor kurrë më e madhe se sot

Komunikimi ndërkulturor është vendosja e ndërveprimit të personave të kulturave të ndryshme, të cilët duhet të kuptohen me njëri-tjetrin edhe pse nuk kanë e as nuk ndajnë të njëjtën përvojë kulturore. Në këtë moment, komunikimi ndërkulturor është më i rëndësishëm se kurrë më parë duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e marrëdhënieve njerëzore, shoqërore dhe shtetërore në të gjitha nivelet, si dhe diversitetin e shoqërive dhe komuniteteve në të gjithë meridianët.

Njerëzit me kultura të ndryshme shpesh bien në kontakt me njëri-tjetrin, veçanërisht në qytetet shumëetnike dhe shumëkombëshe. Këto kontakte krijojnë situata ndërkulturore dhe dialog ndërkulturor, gjegjësisht komunikim. Situata ndërkulturore përbën një situatë në të cilën individit konsideron se besimet, normat dhe zakonet e një individit tjetër janë të ndryshme nga ato të tijat, ndërsa komunikimi ndërkulturor është komunikimi që zhvillohet midis kulturave dhe grupeve të ndryshme shoqërore.

Ai nënkupton shkëmbim të hapur plot respekt, mirëkuptim për pikëpamjet e kundërta për botën, si dhe kuriozitet dhe vullnet për të mësuar diçka të re. Komunikimi ndërkulturor është sfidues, sepse duke njohur dikë që normat dhe këndvështrimin e tij për botën mund të mos i kuptojmë, largohemi nga zona jonë e komfortit dhe hyjmë në zonën e rrezikut.

Duke folur rreth komunikimit ndërkulturor, duhet të dimë se ai vlen njëlloj si për komunikimin verbal ashtu edhe për atë joverbal. Komunikimi verbal i referohet gjuhës që flasim, ndaj është e një rëndësie të madhe njohja e të paktën një gjuhe botërore, e cila mundëson komunikimin ndërmjet anëtarëve të bashkësive të ndryshme gjuhësore.

Komunikimi joverbal përfshin gjestet, mimikat e fytyrës, qëndrimin dhe lëvizjet e trupit (“Gjuha e trupit”) dhe shpesh dërgon mesazhe që keqinterpretohen, keqkuptohen dhe përkthehen gabim. Komunikimi ndërkulturor, si verbal ashtu edhe ai joverbal, kanë të njëjtën rëndësi sepse përmes tyre merret informacioni i plotë, pra kuptohet qëndrimi apo emocioni i bashkëbiseduesit.

## Gërshetimi i kulturës dhe i komunikimit, me rëndësi thelbësore

Gërshetimi, pra lidhja e ndërsjellë ndërmjet kulturës dhe komunikimit, ka një rëndësi të madhe për të kuptuar komunikimin ndërkulturor. Për mësimin e aftësive komunikuese, kultura luan një rol kyç, sepse çdo qytetar e sheh botën përmes njohurive që ka, të cilat janë produkt i kulturës së cilës i përket. Kjo nënkupton se mënyrat, situatat, gjuha dhe stilet gjuhësore të komunikimit tonë me të tjerët, përfshirë edhe sjelljen joverbale, janë fryt i kulturës sonë.

Në rast se kulturat e bashkëbiseduesve janë të ndryshme, gjithashtu edhe komunikimi dhe sjellja e tyre do të ndryshojnë. Prandaj, komunikimi ndërkulturor interpretohet më së miri si diversitet kulturor në përjetimin e ngjarjeve shoqërore në mjedisin që na rrethon.

# PENGESAT NË KOMUNIKIMIN NDËRKULTUROR

## Muret e padukshme të komunikimit ndërkulturor

Në komunikimin ndërkulturor, njeriu shpesh ndeshet me mure të padukshme – barriera, që e bëjnë të vështirë, shpeshherë krejtësisht të pamundur, mirëkuptimin midis njerëzve. Deri më tani, në komunikimin ndërkulturor, teorikisht janë njohur dhe përcaktuar gjashtë lloje barrierash.

**1** Pengesa e parë është supozimi i ngjashmërive. Kur nuk kemi informacion të mjaftueshëm për një kulturë tjetër, është e natyrshme të supozojmë të kemi ngjashmëri me të dhe jo dallime. Nëse në komunikim me njerëzit që rrjedhin nga një kulturë tjetër sillemi tërësisht në përputhje me ngjashmëritë e supozuara, shumë shpejt do të përballlemi me vështirësi ose do të përjetojmë një sërë pakënaqësish. Rreziku qëndron në faktin se, për shkak të ngjashmërisë së supozuar, ne nuk mund ta shohim tablonë e plotë, gjegjësisht t'i shohim dallimet domethënëse. Një rekomandim do të ishte që kur të ndeshemi me një kulturë të re, të mos supozojmë asgjë, por fillimisht të informohemi se çfarë zakonesh dhe normash ka ajo kulturë.

*Për sa u tha më sipër, vlen të përmendet një rast ilustrues dhe i njohur i një gruaje dan-eze, e cila u arrestua në SHBA për neglizhencë të fëmijës, ku më pas kaloi dy net në burg sepse e la fëmijën e saj në një karrocë para një restoranti në Manhattan të New York-ut. Përndryshe, në Danimarkë është praktikë e zakonshme dhe krejtësisht normale që prindërit t'i lënë fëmijët e tyre duke fjetur në karroca para restorantit derisa ata të drekojnë, por kjo nuk është praktikë në SHBA, ndaj qytetarët e shqetësuar, sapo e panë karrocën para lokalit, e denoncuan rastin në polici.*

**2** Përdorimi i gjuhëve dhe i stileve të ndryshme të komunikimit përbën një tjetër pengesë. Përkthimi i gabuar/keqkuptimi i fjalëve, shprehjeve dhe frazave në situatat e komunikimit shumëgjuhësh çon, jo vetëm në vlerësimin e gabuar të qëllimeve të personave të tjerë, por edhe në vlerësimin krejtësisht të pasaktë të palës tjetër si të pasinqertë, të pandershme, arrogante, agresive ose keqdashëse.

Siç është vërtetuar në praktikë, vështirësi tipike përbën tendenca për t'i atribuuar një kuptim të vetëm fjalëve dhe shprehjeve të një gjuhe të huaj, gjegjësisht të përdoren fjalë a shprehje të fjalëpërfjalshme, gjë që mund të jetë burim keqkuptimi. Një tjetër lloj vështirësie është përdorimi i stileve të ndryshme të të folurit – stili i drejtpërdrejtë kundrejt atij të tërthortë, stili i shtrirë kundrejt koncizit, stili autoritar kundrejt atij pajtues.

Në epokën e internetit, gabimet janë shumë të shpeshta për shkak të përdorimit të programit të ashtuquajtur "Google translate", gjegjësisht për shkak të përkthimit softuerik të fjalëve, i cili shumë shpesh jep si rezultat përkthime jashtë kontekstit dhe pa asnjë kuptim.

**3** Pengesa e tretë janë keqinterpretimet e mesazheve joverbale. Shenjat joverbale, ose mesazhet joverbale, mund të kenë kuptime të ndryshme në kultura të ndryshme. Në të njëjtën kohë, në disa kultura, shenjat joverbale kanë më shumë vëmendje dhe rëndësi në komunikim sesa në disa kultura të tjera.

Nuk është e vështirë të paramendohet se si keqinterpretimet e mesazheve joverbale në komunikimin ndërkulturor mund të krijojnë probleme më të mëdha sesa vetë gjuha. Disa shenja dhe simbole joverbale, gjeste ose lëvizje trupore është më e lehtë t'i dallojmë, ndërsa në anën tjetër, shumë prej tyre është më e vështirë t'i pikasësh (për shkak të distancës hapësinore ose trajtimit kohor).

Shembujt e keqinterpretimit të mesazheve joverbale janë të shumtë, kurse më poshtë janë vetëm disa prej tyre:

*Gjestet luajnë një rol të rëndësishëm në komunikim, por kuptimi i tyre mund të jetë shumë i ndryshëm. Bashkimi i gishtit të madh dhe gishtit tregues në formën e një rrethi është një gjest që në Francë nënkupton zero ose diçka që nuk ka vlerë, ndërsa në SHBA i njëjti gjest është shenjë për të treguar se gjithçka është në rregull ose është e pranueshme, derisa në Brazil, po i njëjti gjest ka kuptim fyes dhe madje vulgar, kurse në Japoni është shenjë që nënkupton para.*

*Shumë i përhapur është edhe gjesti i gishtave të ngritur në formën e shkronjës latine "V", i cili në disa vende është simbol i fitores, ndërsa në Britaninë e Madhe ky gjest ka kuptim fyes.*

*Në komunikim, kontakti me sy përdoret në forma të ndryshme. Në vendet arabe, në Amerikën e Jugut dhe në Evropën Jugore gjatë komunikimit bashkëbiseduesi shikohet drejt-përdrejt në sy, ndërsa qytetarët e Azisë dhe Evropës Veriore gjatë komunikimit përgjithësisht vështrojnë përciptazi ose e shmangin vështrimin plotësisht.*

*Gjatë bisedës, anglezët rrallëherë mbajnë kontakt me sy, derisa në Francë kontakti me sy është i shpeshtë dhe shumë intensiv.*

*Gjithashtu, edhe heshtja në komunikim interpretohet ndryshe në kultura të ndryshme. Në Kinë është shenjë e pëlqyeshme dhe tregon respekt, ndërsa në Australi heshtja konsiderohet si shenjë ndrojtjeje apo mosinteresimi.*

*Kështu edhe marrëdhënia me kohën ndryshon nga kultura në kulturë. Koha edhe kuptohet edhe përdoret ndryshe, ndaj fakti se një takim pune është planifikuar për në orën 10:30, ndryshe kuptohet nga vendi në vend. Në Gjermani, Angli dhe Japoni pritet që në takim të mbërrihet para orarit të planifikuar, ndërsa në Francë dhe Spanjë tolerohen vonesat.*

*Raporti me hapësirën gjithashtu ndryshon. Distanca që mbahet derisa zhvillohet një bisedë me një të huaj ndryshon nga kultura në kulturë. Në vendet arabe, distanca midis anëtarëve të të njëjtës gjini është shumë më e vogël se në vendet evropiane ose në Amerikën e Veriut. Distanca hapësinore në Francë është më e vogël sesa në Gjermani ose Britani të Madhe. Nëse dikush e shkel këtë rregull të pashkruar, së paku do të shkaktojë siklet në komunikim.*

*Është gjithashtu e dobishme të informoheni për bindjet, shprehitë dhe zakonet specifike që janë të pranishëm në kultura të caktuara e që shprehen edhe në mënyrë jo-verbale. Në Japoni është e rëndësishme që dhurata të mbështillet, por kursesi me letër të bardhë, sepse ngjyra e bardhë lidhet me vdekjen. Në Tajlandë nuk duhet t'i ledhatoni flokët e fëmijës sepse kjo rrezikon shpirtin e fëmijës i cili qëndron në kokë.*

*Në Itali, numri 17 është i pafat, ndërsa në Japoni numri 14; në vendet arabe hahet vetëm me dorën e djathtë, sepse dora e majtë konsiderohet e papastër meqë përdoret për të mirëmbajtur higjienën; derisa për nikoqirin është ofenduese nëse hahet i gjithë ushqimi nga pjata, sepse ushqimi që ngelet simbolizon bollëk.*

**4** Si pengesë e katërt janë paragjykimet dhe stereotipet. Stereotipet janë mendime të thjeshtëzuara dhe shumë të përgjithshme për anëtarët e grupeve të caktuara. Stereotipet ekzistojnë që njerëzve t'u ndihmojnë për të reduktuar rrezikun nga e pasiguria, duke e bërë kështu botën më të parashikueshme, kurse njerëzve duke ua rritur ndjenjën e sigurisë, veçanërisht kur gjenden në një mjedis të huaj dhe të panjohur.

Është shumë e rëndësishme të kihet parasysh fakti se stereotipet shpesh nuk korrespondojnë me gjendjen objektive reale, kjo përbën edhe arsye pse ato mund të jenë një pengesë e madhe për komunikim. Kur kemi mendime të caktuara stereotipike për një individ nga një kulturë tjetër, ne do ta interpretojmë sjelljen e tij në përputhje me atë mendim, pavarësisht se cila është arsyeja e vërtetë e sjelljes së tij dhe kjo sigurisht nuk çon në mirëkuptim ndërmjet njerëzve.

**5** Prirja për të vlerësuar është pengesa e pestë. Njerëzit priren ta trajtojnë kulturën e vet dhe mënyrën e tyre të jetesës si diçka të natyrshme dhe t'i gjykojnë të tjerët bazuar mbi standardet e veta kulturore. Kur nuk kemi informacione të mjaftueshme për një kulturë të caktuar, zakonisht i miratojmë ose jo veprimet dhe pohimet e pjesëtarëve të asaj kulture, duke i krahasuar ato vetëm me standardet e kulturës sonë dhe me mënyrën tonë të jetesës. Një proverb thotë se ne i shohim gjërat jo ashtu siç janë, por ashtu siç jemi.

Për t'u vendosur një komunikim dhe mirëkuptim i suksesshëm ndërkulturore, është e nevojshme që të jemi mendjehapur dhe qëndrimet e sjelljet e njerëzve që u përkasin kulturave të tjera t'i gjurmojmë duke i parë ato pikërisht nga këndvështrimi i tyre.

**6** Ankthi ose tensioni është pengesa e gjashtë. Çdo komunikim ndërkulturore përmban një sasi të caktuar pasigurie, prandaj ankthi dhe tensioni janë dukuri të zakonshme. Kur qëndrojmë në vende të huaja, jemi të ekspozuar ndaj ndikimeve dhe stimuljeve të shumtë verbalë, joverbalë, fizikë dhe psikologjikë, të ndryshëm nga ata me të cilët jemi mësuar dhe jetojmë në mjedisin tonë të zakonshëm, ndikime këto që mund të jenë shumë stresuese.

Niveli i lartë i ankthit kërkon një lloj çlirimi ose shkarkimi dhe kjo e bën të vështirë për ne të shprehemi dhe të tregojmë atë që duam. Problemi bëhet më i madh kur, si një mënyrë për të çliruar tensionin, ne zgjedhim sjellje jokonstruktive, ose një formë mbrojtjeje, si perceptimi i shtrembëruar ose shmangia dhe armiqësia.

## Rëndësia e përvetësimit të njohurive rreth kulturave të tjera

Vetëdija se gjatë komunikimit ndërkulturor mund të përplasemi me mure të padukshme tregon rëndësinë e përvetësimit të njohurive për kultura të ndryshme dhe aftësisë së njohjes dhe tejkalimit të pengesave “të dukshme dhe të padukshme” në komunikim. Është akoma më e rëndësishme që vështirësitë dhe ngeçjet në komunikim të trajtohen si mundësi për njohuri të reja.

Nëse keqkuptimet dhe konfliktet gjatë takimeve ndërkulturore trajtohen si probleme që duhen shmangur, individi i mohon vetes mundësinë për ngritje dhe zhvillim personal.





## KOMPETENCA NDËRKULTURORE

### Shfrytëzimi i dallimeve si burime mësimore

Kompetenca ndërkulturore është aftësia për t’i njohur dhe për t’i përdorur dallimet kulturore si një burim mësimor. Supozimi fillestar është se njerëzit mund të mësojnë më shumë nga njëri-tjetri kur janë të ndryshëm. Për këtë është i nevojshëm respekti i ndërsjellë dhe një dozë e mjaftueshme kurioziteti, në mënyrë që të kapërcehet tensioni që zakonisht e shoqëron takimin ndërkulturor.

### Elementet kyçe të kompetencës ndërkulturore

Disa nga elementet kryesore të kompetencës ndërkulturore janë:

-  *vetëdija e të qenit një qenie kulturore komplekse;*
-  *ndërgjegjësimi për ndikimin që kultura së cilës i përkasim ka në të menduarit dhe sjelljen tonë;*
-  *aftësia, që, së bashku me të tjerët, të angazhohemi për të hulumtuar paragjykimet e heshtura që ndikojnë në sjelljen tonë;*
-  *testimi i pikëpamjeve të ndryshme të botës, mënyrave të ndryshme të të menduarit dhe zgjidhjes së problemeve.*

Një mbështetje dhe pikënisje e vlefshme në komunikimin ndërkulturor është njohuria për përmasat e dallimeve kulturore. Shumë më pak gabime do të bëhen dhe patjetër që do të ndihemi më të sigurt nëse e dimë se: si trajtohet informacioni, konteksti, koha dhe hapësira në një kulturë të caktuar; si është shpërndarja e pushtetit; orientimi i asaj kulture a është individualist apo kolektivist; a është maskulina apo femina, etj.

Është e rëndësishme të kihet parasysh se disa segmente të caktuara të shoqërisë brenda një kulture mund të ndryshojnë dhe se gjithmonë ka dallime individuale që nuk janë të papërfillshme.



## Etnocentrizmi

Etnocentrizmi ose individualizmi kombëtar, ku kombi i vet është qendra e botës, e bën komunikimin dhe mirëkuptimin ndërkulturor shumë më të vështirë, e ndonjëherë krejtësisht të pamundur. Prandaj, duhet punuar në fusha të ndryshme për ta tejkaluar atë, veçanërisht përmes reformës në arsim dhe integrimin të komponentit ndërkulturor në kurrikulën shkollore.

Është e rëndësishme të theksohet se në asnjë mënyrë kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet të krijojmë lidhje me origjinën dhe trashëgiminë tonë kulturore, ose se duhet t'u japim përparësi disa kulturave të tjera përpara kulturës tonë.

## NDIKIMI I SHKOLLËS NË ZHVILLIMIN E NDËRKULTURALITETIT

### Ndërkulturaliteti nuk është vetëm folklori dhe tradita

Arsimi nuk është vetëm pasqyrë e mjedisit dhe shoqërisë në të cilën zhvillohet, por ai ndikon edhe vetë në zhvillimin e atij mjedisi, ndaj shkolla ka një rol të theksuar në zhvillimin e një komuniteti harmonik multikulturor. Prandaj, arsimi duhet të luajë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe mbështetjen e zhvillimit të shkathtësive, aftësive, vlerave dhe njohurive ndërkulturore, të cilat janë të nevojshme për ta çuar jetën në një komunitet multikulturor.

Që kjo të jetë e mundur, programi i shkollës duhet të përfshijë elemente që mënjanojnë imazhin etnocentrik dhe/ose imazhin hierarkik të kulturave, pra t'i përfshijë ato elemente që trajtojnë veçoritë e kulturave të ndryshme me respekt dhe objektivitet.

Gjithashtu, është e nevojshme të mundësohet ndërlidhja e edukimit ndërkulturor dhe edukimit për qytetari demokratike dhe shoqëri civile. Domethënë, nëse aktivitetet e edukimit ndërkulturor realizohen pa u marrë parasysh pjesëmarrja demokratike në jetën e komunitetit dhe nevojat reale të grupeve të ndryshme kulturore, ekziston rreziku real që edukimi ndërkulturor të reduktohet në folklor, tradita dhe monumente kulturore. Një thjeshtësim i tillë injoron realitetin se nxënësit janë të interesuar për të tashmen dhe për të ardhmen, e jo vetëm për të shkuarën.

Nga ana tjetër, nëse aktivitetet e edukimit për qytetari demokratike dhe shoqëri civile zbatohen pa u marrë parasysh konteksti ndërkulturor, shpërfillet drejtpërdrejt realiteti shoqëror dhe pengohet aftësia e nxënësve për të jetuar, menduar dhe vepruar përgjegjshëm në një kontekst shumëkulturore.

## Ndërkulturaliteti nuk mund të jetë shtojcë e kurrikulës shkollore

Për shkak të natyrës shumëdimensionale, edukimi ndërkulturor nuk mund të jetë vetëm një shtojcë e kurrikulës shkollore, edhe pse në vende të ndryshme kjo përbën një nga mënyrat e nisjes së reformës ndërkulturore. Edukimi ndërkulturor i referohet të gjitha dimensioneve të procesit arsimor: jetës shkollore, vendimmarrjes, edukimit dhe aftësimin profesional të mësimit, plan-programit mësimor, gjuhës së zhvillimit të mësimit, gjuhës përmes së cilës mësimit japin udhëzime dhe detyra, metodave të mësimit, ndërveprimit ndërmjet nxënësve, teksteve dhe materialeve të punës. Edukimi ndërkulturor duhet të përfshijë edhe mjedisin në të cilin zhvillohet mësimi.

I kuptuar në këtë mënyrë, edukimi ndërkulturor kërkon përfshirjen e pikëpamjeve të ndryshme dhe një mënyrë e mirë për ta arritur këtë është zhvillimi i një kurrikule gjithëpërfshirëse që përmban mësimin e gjuhëve, historisë dhe kulturave të grupeve pakicë në shoqëri.

Prandaj, edukimi ndërkulturor duhet të promovojë kushtet, që shoqërinë e çojnë drejt pluralizmit përmes rritjes së ndjeshmërisë ndaj kulturës së vet, duhet t'u kujtojë fëmijëve faktin se ekzistojnë mënyra të tjera të veprimit dhe sisteme të tjera vlerash, si dhe të zhvillojë tek fëmijët respektin për stilet e jetesës që ndryshojnë nga të tyre, në mënyrë që të mund të kuptojnë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Nuk është më pak e rëndësishme, që edukimi ndërkulturor të promovojë përkushtimin ndaj barazisë, t'i udhëzojë fëmijët, që përmes njohjes së fakteve të marrin vendime dhe të bëjnë zgjedhjet e duhura, si dhe të nxisin aktivitete që synojnë luftimin e diskriminimit dhe paragjytimeve.

Të mësosh të jetosh së bashku me të tjerët nënkupton zhvillimin e mirëkuptimit për të tjerët dhe rëndësinë e varësisë reciproke në frymën e respektit për vlerat e mirëkuptimit të ndërsjellë, paqes dhe diversitetit kulturor. Këto vlera universale arrihen edhe duke mësuar se si të menaxhohen konfliktet dhe duke marrë njohuri dhe aftësi që kontribuojnë në frymën e solidaritetit dhe bashkëpunimit midis individëve dhe grupeve të ndryshme në shoqëri.

*Këshilli i Evropës: "Në të ardhmen, qytete të suksesshme do të jenë ato ndërkulturore. Ato do të jenë në gjendje ta menaxhojnë diversitetin kulturor dhe të hulumtojnë potencialin e tij, të nxisin kreativitetin dhe inovacionin, që në këtë mënyrë të arrijnë mirëqenien ekonomike, kohezionin e komunitetit dhe cilësi më të mirë të jetesës"*

## **ULQINI DHE TIVARI, SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA NDËRKULTURORE NË MAL TË ZI**

Ndërkulturaliteti është qëndisur në mënyrën më të bukur të mundshme në hartën kulturore të Malit të Zi, pikërisht në jugun e tij, në Ulqin dhe Tivar.

Gërshetimi mijërvjeçar i kulturave të shumta i dha formë relievit të sotëm të ndërkulturalitetit në Ulqin dhe në këtë mënyrë i dha atij një themel historik të pathyeshëm për statusin e sotëm - si një qytet vërtetë i hapur, i cili pranon dhe mirëpret si të vetin çdo njeri dashamirës.

Diversiteti i jashtëzakonshëm kulturor i Ulqinit është së shumti mbresëlënës në trashëgiminë kulturore-historike të arkitekturës së tij, në të cilën ndërthuren zotësitë e ndërtueseve nga qytetërime dhe epoka të ndryshme historike, sikur edhe në të gjitha fushat e tjera të trashëgimisë kulturore.

Së bashku me Tivarin e Vjetër, Qyteti i Vjetër i Ulqinit përfaqëson shembullin më të dukshëm të ndërthurjes së kulturës urbane e arkitekturore mesdhetare dhe orientale-ballkanike.

Jeta lulëzoi në bukurinë e diversitetit edhe përreth mureve të saj të fuqishme, duke krijuar një mikrokozmos unik ndërkulturor të Ballkanit, ku sot jetojnë së bashku shqiptarët, malazezët, boshnjakët, serbët, myslimanët, romët dhe egjiptianët, kroatët dhe qytetarë të tjerë.

Fati gjeografik dhe historik i jetës në kufi, nuk i solli këtij qyteti një kujtesë kolektive të rënduar me konflikte dhe përçarje, por përkundrazi, shkaktoi homogjenitet dhe lidhje më të forta shoqërore të të gjithë atyre që vendosën ta bëjnë shtëpi të tyre Dolciniun e famshëm, që me siguri është shembulli më i dukshëm i ndërkulturalitetit në këto hapësira.

Sot, qyteti i lavdishëm i Tivarit, siç e quanin dikur, së bashku me rrethinat e tij, ilustron më së miri përkufizimin e ndërkulturalitetit si mënyrë e jetesës që mundëson mirëkuptimin dhe bashkëpunimin midis pjesëtarëve të kulturave të ndryshme, respektivisht grupeve identitare në ndërveprim shoqërore, duke zvogëluar ose çrrënjësuar kështu paragjykimet dhe stereotipet për të tjerët.

Banorët e Tivarit, shumica e të cilëve kanë një identitet të theksuar urban, kanë parashikuar me korrektësi që vlerat e kulturave të tjera të mos maten dhe vlerësohen sipas standardeve të kulturës së tyre dhe për këtë arsye, sot, shumica e tivarasve i pranojnë rrethanat se ndonjëherë, qoftë edhe dallimet e thella të bindjeve dhe zakonet shoqërore, nuk duhet dhe nuk guxojnë të çojnë në keqkuptime dhe konflikte të ndërsjella.

Në Tivar shpesh mund të dëgjojmë se rruga drejt krijimit të vlerave të përbashkëta arrihet përmes tolerancës ndaj dallimeve, ndërsa historia e pasur e rajonit të Nënrumisë, si në det ashtu edhe në anën e liqenit, ka bërë që në këtë hapësirë të mbijetojnë përvojave unike, jo vetëm ndaj kulturave të ndryshme, por edhe ndaj specifikave brenda të ashtuquajturave 'kultura të veta'.

Prandaj, kulturat nuk janë modele sjelljeje të kufizuara dhe të pandryshueshme, por fuqia e tyre e përshtatshmërisë buron nga vlerat autentike, të cilat duhen trajtuar me respekt dhe tolerancë. Të ofrosh, jo të imponosh, është koncepti i një shoqërie të hapur. Në historinë e futjes së ndërkulturalitetit në programet mësimore, përvoja e deritanishme e Ulqinit dhe Tivarit mund të shërbejë si shembull i një praktike të shkëlqyer.

## NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Duke e parë këtë temë nga disa këndvështrime, mund të themi se qëllimi i edukimit ndërkulturor institucional dhe jointucional është mirëkuptimi dhe pranimi i njerëzve që vijnë nga kultura të tjera dhe se ai u drejtohet të gjithë njerëzve, pa përjashtime. Ndërkulturaliteti, në dritën e të gjitha fakteve të paraqitura, do të thotë ta kuptosh tjetrin dhe të jesh në marrëdhënie ndërvepruese me të, ku termi të kuptuarit nuk përbën thjesht një grumbullim informacioni dhe bisedë për të tjerët, por ka një efekt proaktiv dhe do të thotë të flasësh me të tjerët, t'i dëgjosh të tjerët dhe t'u kthesh përgjigje dhe në këtë marrëdhënie të mësosh dhe njëkohësisht të japësh mësim.